

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektligji “Për policinë bashkiake”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Për këtë projektakt, ka pasur një grup pune të ngritur me urdhrin e ministrit të Brendshëm nr. 680, datë 27.12.2018, i cili si fillim ka nisur punën për hartimin e këtij projektligji dhe janë zhvilluar vazhdimisht komunikime online të grupit të punës për hartimin e draftit të aktit, referuar dhe masave kufizuese për shkak të pandemisë të krijuar nga Covid-19.

Duke filluar nga mesi i vitit 2020 ka vazhduar puna për identifikimin e grupeve të interesit, përcaktimin e metodave të konsultimit dhe janë zhvilluar vazhdimisht takime të grupit të punës, si dhe takime online me shoqatat e bashkive.

Në zbatim të urdhrin të ministrit të Brendshëm me nr. 302, datë 13.9.2021, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për policinë bashkiake””, me qëllim rritjen e rolit të policisë bashkiake, është ngritur grupi i punës i cili është mbledhur më datë 12 tetor 2021, në ambientet e Ministrisë së Brendshme. Më pas, puna ka vijuar me marrjen e mendimeve të Bashkisë Tiranë, Pameca V, Shoqatës për Autonominë Vendore dhe të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë dhe normalisht të ministrive të linjës, komentet e të cilave janë pranuar gjerësisht.

Gjithashtu, në datat 19 nëntor 2021 dhe 23 dhjetor 2021 është zhvilluar takimi i Këshillit Konsultativ i Qeverisë Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, me pjesëmarrjen e: NJVV, donatorë të huaj, drejtues të projekteve të ndryshme në lidhje me vetëqeverisjen vendore, përfaqësues nga ambasada të ndryshme.

Duke përfunduar më pas, me procesin e konsultimit publik nëpërmjet publikimit të projektvendimit në RENJK më 16 nëntor 2021 deri më 14 dhjetor 2021. Pas kalimit të afatit ligjor 20 (njëzet) ditor nga publikimi i tij të përcaktuar në ligj, nuk u përcoll asnjë koment mbi përmbajtjen apo fushën e veprimit të projektligjit dhe relacionit shoqëruar nga palët e interesuara. Më tej, ka vijuar procesi i marrjes së mendimeve dhe i bashkërendimit me ministrinë e linjës.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara

të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektvendimin “Për propozimin e projektligjit “Për Policinë Bashkiake””, ishin:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK.
2. Takime me grupin e punës fizikisht dhe online.
3. Takime online me grupet e interesit, shoqatat e bashkive, bashkitë.
4. Tryeza publike e Këshillit Konsultativ të Qeverisë Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, me pjesëmarrjen e: NJVV, donatorë të huaj, drejtues të projekteve të ndryshme në lidhje me vetëqeverisjen vendore, përfaqësues nga ambasada të ndryshme, Këshillat e Qarqeve.
5. Posta elektronike (përmes së cilës janë përcjellë komentet e organizatave jofitimprurëse).

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

1. Grupi i punës të mëparshëm i ngritur me urdhrin e ministrit të Brendshëm nr. 680, datë 27.12.2018, i cili si fillim ka nisur punën për hartimin e këtij projektligji.
2. Grupi i punës i ngritur me urdhër të ministrit të Brendshëm nr. 302, datë 13.9.2021, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për policinë bashkiake”” (10 anëtarë).
 - Drejtoria e Politikave dhe Strategjive për Çështjet Vendore në MB,
 - Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore,
 - Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në MB,
 - Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB,
 - Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MB,
 - Departamenti i Sigurisë Publike dhe Drejtoria Juridike në DPPSH.
3. Grupet e interesit, Bashkia Tiranë, Pameca V, Shoqata për Autonominë Vendore dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, Shoqata e Këshillave të Qarqeve.
4. Në 19 nëntor 2021 është parashikuar takimi i Këshillit Konsultativ i Qeverisë Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore, me pjesëmarrjen e: NJVV, donatorë të huaj, drejtues të projekteve të ndryshme në lidhje me vetëqeverisjen vendore, përfaqësues nga ambasada të ndryshme.
5. Koordinatorin për konsultimin në MB për mbledhjen e mendimeve nëpërmjet RENJK.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja adresuar	Komenti	Palët e interesuara	Vendimi (I pranuar/ I pranuar pjesërisht/ I refuzuar)	Justifikimi
Kompetenca mbi menaxhimin e trafikut	Policia Bashkiake duhet të ketë kompetenca për të menaxhuar trafikun brenda territorit të saj, sipas përcaktimeve të Kodit Rrugor.	Pameca V	I pranuar	Në projektligj është përcaktuar si kompetencë në fushën e rendit dhe sigurisë në komunitet, se Policia Bashkiake: <i>“kontrollon zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor në territorin e juridiksionit të saj, sipas parashikimeve në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjeve të bashkëpunimit që lidhen me Policinë e Shtetit”;</i>
Neni 7 <i>“Ministri përgjegjës përcakton me udhëzim numrin e punonjësve të Policisë Bashkiake, duke e përlllogaritur në referim të popullsisë faktike dhe sipas specifikimeve që</i>	Nëse Ministria do të përcaktojë numrin të përcaktojë dhe strukturën dhe të bëhet shërbim i deleguar që njësia vendore të mos shpenzojë para as për rroga.	Shoqata e Bashkive të Shqipërisë	I pranuar	Lidhur me komentin sqarojmë se, riformuluam në nenin 6 pika 2, duke përcaktuar se raportin e numrit dhe jo numrin e punonjësve të policisë bashkiake: <i>“Ministri përgjegjës përcakton me udhëzim raportin e numrit të punonjësve të policisë</i>

<p><i>i nevojiten çdo bashkie”.</i></p>			<p><i>bashkiake për numër të popullsisë efektive bazuar mbi veçoritë e bashkive.”</i></p> <p>Ky parashikim lind si nevojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • në bazë të ndarjes administrative-territoriale të vitit 2014, bashkitë pësuan ndryshime drastike të popullsisë dhe territorit të tyre, për të cilën lind nevoja e ndryshimit të numrit të përcaktuar për këtë strukturë. • Vendosija e raportit/kritereve të njëjta për të gjitha bashkitë për përcaktimin e numrit maksimal të punonjësve të Policisë Bashkiake që do miratohet nga Këshilli Bashkiak. • Sikurse, ky raporti do të përcaktohet edhe në bazë të veçorive të bashkive, si p.sh. bashki që përballojnë një numër të madh turistësh gjatë sezonit turistik ose bashki të mëdha si Tirana, Durrësi, Shkodra, Vlora që krahas numrit të madh të popullsisë
---	--	--	--

				<p>kanë edhe një shtrirje të gjerë territoriale.</p> <ul style="list-style-type: none">• Termi efektiv është përdorur me qëllim për të treguar numrin faktik/real të popullsisë, pavarësisht përcaktimit të këtij numri në regjistrat e gjendjes civile. Gjithashtu ky numër përdoret edhe në formulën e transfertës së pakushtëzuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për qeverisjen vendore.• Gjithashtu, kjo edhe në zbatim të nenit 22 të ligjit organik për vetëqeverisjen vendore “<i>Parimet për ushtrimin e funksioneve</i>” ku përcaktohet se: Njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet duke respektuar politikat kombëtare dhe rajonale. Për këto funksione, qeverisja qendrore mund të vendosë standarde e norma specifike të përgjithshme, me qëllim ruajtjen e interesave
--	--	--	--	--

				kombëtarë dhe ofrimin e shërbimeve cilësore.”
Në nenin 6, (Struktura) është parashikuar se: <i>“Këshilli Bashkiak miraton strukturën dhe organikën e Policisë Bashkiake”</i> .	Në bazë të nenit 64 të ligjit 139/2015 <i>“Për vetëqeverisjen vendore”</i> , i ndryshuar, këtë kompetencë e ka Kryetari i Bashkisë.	1. Shoqata e Bashkive të Shqipërisë 2. Shoqata e Këshillave të Qarqeve 3. Shoqata për Autonomi Vendore	I pranuar	Lidhur me këtë koment, sa i takon strukturës dhe organikës të policisë bashkiake, referuar dispozitave të ligjit organik për vetëqeverisjen vendore, këtë kompetencë e ka Kryetari i Bashkisë, ashtu siç është tashmë reflektuar në këtë projektligj.
Në nenin 10, (Procedura e konstatimit dhe shqyrtimit të kundërvajtjes), pika 6 parashikon: <i>“Kundër procesverbalit nëpërmjet të cilit është vendosur gjobë, paraqitet ankim administrativ pranë Bashkisë, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.”</i>	Është pak e paqartë cili është organi përgjegjës për shqyrtimin e ankimit? A do të jetë brenda strukturës së policisë bashkiake apo tek Kryetari i Bashkisë? Kodi i Procedurave Administrative parashikon se ankimi bëhet tek organi epror. Cili është në këtë rast?	Shoqata e Bashkive të Shqipërisë	I pranuar	Në lidhje me këtë koment duke marrë dhe parasysh komentet nga ministritë e linjës, nenet 9,10,11 që parashikojnë kundërvajtjen u riformuluan e përmbledhur në nenin aktual 9 <i>“Kundërvajtjet administrative”</i> , duke shtuar pikën 5, në të cilën është përcaktuar referenca ligjore mbi procedurën që do të ndjekë punonjësi i Policisë Bashkiake, nga momenti i konstatimit të kundërvajtjes e deri në përfundim e saj, duke ju referuar dispozitave ligjore të kundërvajtjes administrative, me qëllim shmangien e çdo interpretimi të mundshëm.

<p>Neni mbi (Simbolet dhe uniforma) Pika 1 përcakton: <i>“Këshilli Bashkiak miraton stemën e Policisë Bashkiake sipas bashkisë përkatëse.”</i></p>	<p>Nëse për uniformën është me VKM, por për stemën e cila me një ligj tjetër bashkive ju është hequr e drejta të përdorin stemat e tyre në dokumentacion zyrtar ose dualitetin e dy stemave?</p> <p>2. Nuk përcaktohet në uniformën e policit kush janë mjetet e tij gjatë ushtrimit të detyrës, siç është përcaktuar në Policinë e Shtetit.</p>	<p>Shoqata e Bashkive të Shqipërisë</p>	<p>I pranuar</p>	<p>Lidhur me këtë koment është pranuar dhe janë bërë ndryshimet përkatëse në nenin 27 (Uniforma dhe shenjat dalluese) dhe duke përcaktuar se: <i>“Punonjësi i Policisë Bashkiake detyrohet të përdorë uniformën dhe shenja dalluese të veçanta, vetëm gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj. Uniforma dhe shenjat dalluese miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Punonjësi i Policisë Bashkiake, gjatë kryerjes së detyrës identifikohet me dokumentin individual të identifikimit. Modeli dhe të dhënat që përmban dokumenti individual i identifikimit përcaktohen në rregulloren kuadër</i></p> <p>Ndërsa, lidhur me stemën e policisë bashkiake, sqarojmë se, referuar nenit 54 të ligjit 139/2015, i ndryshuar, e cila parashikon si detyrë të këshillit bashkiak miratimin e simboleve, pra edhe të stemës së bashkisë, kompetencë e cila është reflektuar edhe në këtë projektligj, si rrjedhojë nënkuptohet</p>
--	--	---	------------------	--

				që stema e Bashkisë përkatëse do të përdoret edhe si stemë e Policisë Bashkiake, që është e ndryshme për secilën bashki.
--	--	--	--	--